



Datë: 12.05.2025
Numër protokolli: 3233/2025

A.nr.552/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.552/2025, të datës 26.03.2025, të parashtruar nga ankuesi, B.S., kundër Vendimit A.nr.01/2025, të datës 18.02.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.552/2025 të datës 26.03.2025, të parashtruar nga ankuesi B.S.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, B.S., (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), më datë 26.03.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmshek@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar po të njëjtën datë nën shenjë A.nr.552/2025, kundër Vendimit A.nr.01/2025, të datës 18.02.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes së cilit është anuluar procedura e rekrutimit me numër reference RN00015135, e shpallur nga Inspektorati i Punës, për pozitën Inspektor i Punës, Njësia Rajonale Pejë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, ***sepse***:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 13.09.2024, ka shpallur konkursin me Nr. referencës RN00015135, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Pejë, klasa profesional 1, numri i kërkuar 7 vende, me afat aplikimi 14.09.2024 deri 13.10.2024.

Tutje, sipas provave materiale të çështjes del së në konkursin përkatës kanë aplikuar (173) kandidatë përfshirë edhe ankuesin, i cili sipas Njoftimit me numër protokolli Nr.3378 të datës 24.12.2024, të Njesisë të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, i njëjti është shpallur si kandidat fitues për pozitën përkatëse me 81.2, me renditje në listë me numër 5.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.01/2025, të datës 03.01.2025, të parashtruar nga kandidatja A.C., me Vendimin A.nr.01/2025, të datës 18.02.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankueses, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015135, për pozitën Inspektor i Punës, Njësia Regjionale në Pejë.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.01/2025, të datës 18.02.2025, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli Nr.577 të datës 19.03.2025, nga i cili njoftim rezulton se procedura e rekrutimit me reference RN00015135, është anuluar.

Pas publikimit të njoftimit me numër protokolli Nr.577 të datës 19.03.2025, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nën supozimin se Vendimi për anulimin e konkursit përkatës të punësimit nuk përmban arsyetim të qartë, ankesa e kandidatëve tjerë në këtë proces rekrutimi nuk duhet të cenoj integritetin e procesit, tutje sipas ankuesit me anulimin e konkursit me reference RN00015135, është shkelur parimi i barazisë dhe meritokracisë. Kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën dhe të rishqyrtoj edhe njëherë vendimin për anulim të konkursit.

Andaj, nisur nga gjendja e fakteve si me sipër, Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***, vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, mbi faktin se Këshilli me vendim përfundimtar ka vendosur lidhur me ligjshmërinë e procedurës së pranimit me numër reference RN00015135, rrjedhimisht duke e anuluar të njëjtën si të paligjshme.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.552/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, B.S.;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së